- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshëm i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektit dhe të jetë dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbyshja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 613-25-4161-5-1-1/C1084

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 13 muaj , apo shprehur nominalisht shuma e sigurimit të ekzekutimit është 49.280.30EUR.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit tekontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim Pajisjeve në shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 10 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 10 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të kontratës
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 3 dite pas nënshkrimit të kontratës nga të dy palët në marrëveshje. Gjatë vitit 2025 do të kryhen punë në vlerë prej 267.000.00€

	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: Llot 1 90 dite pune te ndara ne dy vite fiskale viti 2025 dhe 2026 sipas mjeteve buxhetore por jo me vone se 30.07.2026.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë [0.25%] për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është [10%] e Çmimit final të Kontratës
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit caktohet : Armend Aliu, udheheqes, Besart Zejnullahu, anetar. Rinor Hajrizi MDMK
Pagesat	24	Pagesat do të bëhen sipas situacioneve të përfunduara ne teren dhe të pranuar nga menaxheri i kontratës duke mbajtur 10% nga secila faturë deri sa të arrin shuma 90% e mjeteve të paguara. Pjesa e mbetur për pagesë prej 10% do t'i paguhet kontraktuesit pas leshuarjes se certifikates se perkoheshme te pranimit, pagesat e para në vlerë prej 235.000.08 do te kryhen nga DEMOS sipas memorandumit PJESA TJETER nga Autoriteti kontraktues (Komuna e Lipjanit)
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura: kontraktuesi do te sjelle sigurimin e garancionit mbi kualitetin e punimeve 10% te vleres se kontrates per 1 vit apo 12 muaj i cili do te përdoret për përmirësim te defekteve, Certifikata do të lëshohet OE sipas nenit 33 të KPK, në formën e publikuar nga ana e KRPP-së, CERTIFIKATË E PRANIMIT TË PËRKOHSHEM të punëve, njashtu pas përfundimit afatit të kualitetit OE i lëshohet CERTIFIKATË E PRANIMIT PËRFUNDIMTAR, sipas manualit-doracakut të KRPP-së, i publikuar më dt 08.07.2024.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 10% të vlerës së kontratës ne forme te sigurimit (sigurimi mbi kualitetin e punimeve) ne afat 1 vjeçar apo 12 muaj pas CERTIFIKATË E PRANIMIT TË PËRKOHSHEM.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

A. PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Dobraj e Madhe

Vërejtje: Bazuar edhe në Emërtimin e Dokumentit sasitë e prezantuara janë të Paralogaritura. Punëkryesi duhet t'ia prezantoj përmes:

1 Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Dobraj e Madhe					
NR. 1	LLOJI I PUNËS	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI NJËSI ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.1	Pastrimi i terenit nga gjithsendet, dhe vendosja e shennjave që është duke u punuar gjatë ekzekutimit të punimeve	m'	3500.00	2.00	€ 7,000.00
1.2	Rrafshimi i nënbazës me ngjeshje (45MN/m ²) me cilindër vibrues.	m ²	1500	2.00	€ 3,000.00
1.2	Gërmimi i dheut i kategorisë së III, IV dhe V-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi 15km. Vërejtje në kuadër të punëve toksore kalkulohet edhe kanali atmosferik në form trapezi nëse është i nevojshëm për trajtimin e ujërave atmosferik	m ³	6500.00	3.00	€ 19,500.00
1.3	Punimi i mbushjes (satbilizues 0-128 mm) t=40 cm me material guror jokohërent me shtrirje në shtresa dhe ngjeshje duhet të arrijnë ngjeshja 45 N/mm ² .	m ³	6000.00	6.00	€ 36,000.00
1.4	Punimi i bankinave me material guror (0-31.5)mm 10 cm.Sasia e llogaritur m ³ në gjendje të ngjeshur.	m ³	350.00	6.00	€ 2,100.00
1.5	Punimi i lëshesave Gypore me diameter Ø 400 mm,ne çmim të përfshihet edhe punimi i kokave sipas detajeve në projekt,me beton të klases C25/30 të deshmuara me ateste. Vërejtje ky pozicion aplikohet apo paguhet për punë që janë nevojshme teren.	m'	160.00	10.00	€ 1,600.00
1.6	Furnizimi me material dhe Punimi i kokave të lëshesave ekzistuese sipas detajeve në projekt,me beton të klases C25/30	copë	37.00	10.00	€ 370.00
1.7	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-63 mm me trashësi t=20cm,matjet duhet të behen me pllake rrethore qdo 50 m' të cilat duhet të arrijnë ngjeshjet 60 N/mm ² .	m ³	3100.00	10.00	€ 31,000.00





1.8	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=8-13cm, me ngjeshje me cilindër me vibracion, si dhe pas rrafshimit dhe ngjeshjes, duhet të behen matjet e nënbazës të cilat duhet të arrijnë ngjeshjet 70 N/mm ² . Të deshmuar me ateste, matjet duhet të behen me pllake rrethore qdo 50 m'	m ³	1600.00	10.00	€ 16,000.00
1.9	Furnizimi dhe punimi i shtresës së asfaltbetonit 0-16mm me trashësi t=8cm në gjendje të ngjeshur. Në çmim të kalkulohen edhe testet marshall sipas standardeve për këtë pozicion.	m ²	11300.00	11.00	€ 124,300.00
2.0	Demolimi i Asfaltit dhe Kubzave ekzistuese dhe materialeve tjera, pas demolimit të bëhet dhe largimi i tyre në deponi.	m ²	840.00	1.00	€ 840.00
2.1	Ngjritja nivelizimi si dhe pershtatja me nivelin e asfaltin e ri të pusetave ekzistuese. Në çmim të kalkulohet materiali i nevojshëm me punë dhe kapaku nga materiali metalik për peshë 40 ton. Komplet për copë. Vërtetë ky pozicion aplikohet apo paguhet për punë që janë nevojshme teren.	copë	43.00	1.00	€ 43.00
2.2	Shërbimet konsultative, teknike gjatë fazës implementimit projektit si dhe Hartimi i projektit detaj nga ana e kompanisë, pas përfundimit të projektit "ASB Drawing", duke përfshirë të gjitha elementet përcjellëse të niveletës situacioni, gjatësori, tërthoret, Detalet, etj.	m'	3500.00	0.50	€ 1,750.00
			Totali me TVSH		€ 243,503.00

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Në rast se projekti gjatë ekzekutimit pëson ndryshime, atëherë pas përfundimit të

Pos	Përshkrimi	Vlera me TVSH në €
A	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Dobraj e Madhe	243,503.00
TOTALI I PËRGJITHSHËM ME TVSH		243,503.00



B. Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin LLUGAXHI

Vërejtje: Bazuar edhe në Emërtimin e Dokumentit sasitë e prezantuara janë të Paralogaritura. Punëkryesi duhet tja prezantoj përmes Librit Ndërtimorë Vlerat Reale Organit Mbikqyrës për Verifikim dhe Evaluim..Në çmim duhet të përfshihet furnizimi i materialit, instalimi dhe sjellja e produktit në gjendje funksionale. Të gjitha produktet duhet të jenë kualitative dhe ofertuesi në ofertën e tij duhet të përfshij certifikatat e kualitetit dhe te standardeve.

1	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Llugaxhi				
NR. 1	LLOJI I PUNËS	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI NJËSI ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.1	Pastrimi i terenit nga gjithsendet, dhe vendosja e shenjave qe eshte duke u punuar gjate ekzekutimit te punimeve.	m'	3500.00	€ 2.00	€ 7,000.00
1.2	Gërmimi i dheut i kategorisë së III, IV dhe V-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi 15km. Vërejtje në kuadër të punëve toksore kalkulohet edhe kanali atmosferik në form trapezi nëse është i nevojshëm për trajtimin e ujërave atmosferik	m³	5600.00	€ 3.00	€ 16,800.00
1.3	Rrafshimi i nënbazës me ngjeshje (45MN/m²) me cilindër vibruës.	m²	14000.00	€ 2.00	€ 28,000.00
1.4	Punimi i mbushjes (satbilizues 0-128 mm) t=30 cm me material guror jokoherent me shtrirje në shtresa dhe ngjeshje duhet te arrijne ngjeshja 45 N/mm2 .	m³	5600.00	€ 6.00	€ 33,600.00
1.5	Punimi i bankinave me material guror (0-31.5)mm 10 cm.Sasia e llogaritur m³ në gjendje te ngjeshur.	m³	350.00	€ 6.00	€ 2,100.00
1.6	Punimi i lëshesave Gypore me diameter Ø 400 mm,ne çmim të përfshihet edhe punimi i kokave sipas detajeve në projekt,me beton te klases C25/30 te deshmuara me ateste. Vëretje ky pozicion aplikohet apo paguhet për punë që janë nevojshme teren.	m'	50.00	€ 6.00	€ 300.00
1.7	Furnizimi me material dhe Punimi i kokave te lëshesave ekzistuse sipas detajeve në projekt,me beton te klases C25/30	copë	30.00	€ 6.00	€ 180.00
1.8	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-63 mm me trashësi t=20cm,matjet duhet te behen me pllake rrethore qdo 50 m' te cilat duhet te arrijne ngjeshjet 60 N/mm2 .	m³	2800.00	€ 10.00	€ 28,000.00




1.9	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=8-13cm, me ngjeshje me cilindër me vibracion, si dhe pas rrafshimit dhe ngjeshjes, duhet të behen matjet e nënbazës të cilat duhet të arrijnë ngjeshjet 70 N/mm ² -Te deshmua me ateste ,matjet duhet të behen me pllake rrethore qdo 50 m'	m ³	1400.00	€ 10.00	€ 14,000.00
2.0	Demolimi i Asfaltit dhe Kubzave ekzistuese dhe materialeve tjera.	m ²	720.00	1.00	€ 720.00
2.1	Furnizimi dhe punimi i shtresës së asfaltbetonit 0-16mm me trashësi t=8cm në gjendje të ngjeshur. Ne çmim të kalkulohen edhe testet marshall sipas standardeve për këtë pozicion. Te sillen atestet e nevojshme.	m ²	10600.00	€ 11.00	€ 116,600.00
2.2	Ngritja nivellizimi si dhe pershtatja me nivelin e asfaltin e ri të pusetave ekzistuese. Ne çmim të kalkulohet materiali i nevojshëm me punë dhe kapaku nga materiali metalik për peshë 40 ton. Komplet për copë. Vërtetë ky pozicion aplikohet apo paguhet për punë që janë nevojshme teren.	copë	25.00	€ 10.00	€ 250.00
2.3	Shërbimet konsultative ,teknike gjatë fazës implementimit projektit si dhe Hartimi i projektit detaj nga ana e kompanisë, pas përfundimit të projektit "ASB Draiwng", duke përfshi të gjitha elementet përcjellëse të niveletës situacioni, gjatësori, tërthoret, Detalet, etj.	m'	3500.00	€ 0.50	€ 1,750.00
Totali me TVSH				€	249,300.00

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Në rast se projekti gjatë ekzekutimit pëson ndryshime, atëherë pas përfundimit të

Pos	Përshkrimi	Vlera me TVSH në €
A	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Llugaxhi	249,300.00
	TOTALI I PËRGJITHSHËM ME TVSH	249,300.00

€ 492,803.00





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë: 11.08.2025

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, rregullorës për prokurim publik NR; 001/2022, dhe udhëzuesi nxjerrë:

V E N D I M

Caktohet Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësit i realizimit të kontratës për kontratën me titullin: **Llot 1 Asfaltimi i rrugicave në Llugaxhi dhe Dobrajë e Madhe-faza III-të**, me numër identifikues: **613-25-4161-5-1-1**

1. **Armend Aliu**, Drejtoria për Infrastrukturë, caktohet menaxher i kontratës, kryesues
 2. **Besart Zejnullahu**, Drejtoria për Shërbime Publike, caktohet menaxher i kontratës, anëtar
1. Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë për realizimin e kontratës sipas pikës 1 dhe të këtij vendimi caktohet:
 - a) **Rinor Hajrizi**, Drejtoria për Infrastrukturë.
 2. Menaxheri i kontratës, obligohet që të hartoj një Plan të të Menaxhimit të Kontratës, duke përdorur formularin Standard të miratuar nga KRPP, i cili duhet të nënshkruhet nga ana e të dy palëve (Menaxherit të kontratës së AK dhe Menaxherit të Kontratës së OE) para inicimit të zbatimit të kontratës dhe një kopje të nënshkruar të planit për menaxhimin e kontratës do ta përcjelle tek departamenti i prokurimit.
 3. Menaxheri i kontratës e menaxhon kontratën deri në pranimin e plotë të [artikujve/shërbime/punëve] të kërkuar respektivisht deri në përmbylljen e kontratës.
 4. **Përgjegjësitë dhe funksionet e Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejt për menaxhim të kontratës janë:**
 - a) Monitorimin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, dhe
 - b) Rishikimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të përfundimit të kontraktuesit – vlerësime të propozuar nga menaxherët e kontratave nën mbikëqyrjen e tij.
 5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kopje: Menaxherve të projektit;
Mbikëqyrësit të MDMK-së.
Departamentit të Prokurimit;

Zyrtari Kryesor Administrativ
Imri Ahmeti

Komuna e Lipjanit



SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT

Për: **KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues").

Në emër të: **NNT ABC SH.P.K. , Rr. Jim Xhema, nr. 14 Prishtine**
(në vazhdim "operatori ekonomik").

Titulli i aktivitetit të prokurimit dhe Numri i prokurimit: Llot 1 Asfaltimi i rrugicave në Llugaxhi dhe Dobrajë e Madhe-faza III-të
613-25-4161-5-1-1

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri;

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **Katerdhjete e Nent mije e Dy qinde e Tetedhjete e Tre 49,280.30 €** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetë pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **49,280.30 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejt që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin 'e pranimit'.

Kjo siguri është e vlefshme **395** ditë prej **29.07.2025** deri më **28.08.2026**

Garancioni në fjalë skadon tërësisht dhe në mënyrë automatike nëse kërkesa e juaj nuk ka arritur në K.S "SIGKOS" sh.a më së voni deri në datën e shënuar më lartë.



SIGKOS
KOMPANIA E SIGURIMEVE
INSURANCE COMPANY
Agjent në sigurime
NRE 310055865

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

Emri i bankës ose i institucionit financiar

K.S. "SIGKOS" Sh.a.
Lagjja Kalabria, Kompleksi Riera, Hyrja Z10, Magjistrallja
Prishtinë-Shkup, 10000 Prishtinë, Kosovë

Data
21.07.2025

KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN

NJOFTIM PËR KONTRATË

☒ **PUNË**

☐ **FURNIZIM**

☐ **SHËRBIME**

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 16.05.2025

Nr i Prokurimit	613-25-4161-5-1-1
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN		
Adresa Postare: SHQIPERIA		
Qyteti: LIPJAN	Kodi postar: 14000	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Bekim Shabani		Telefoni: +383 3820041526
Email: bekim.g.shabani@rks-gov.net		Faksi:
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):		

Po ☐ Jo ☒

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:

Llot 1 Asfaltimi i rrugicave në Llugaxhi dhe Dobrajë e Madhe-faza III-të, Llot 2 Rikonstruimi i rrugës Poturovc - Ribar I Madh

II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit

(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

☒ Punë

☐ Furnizime

☐ Shërbime

☒ Ekzekutim

☐ Plani dhe ekzekutimi

☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa

☐ Blerja

☐ Qira financiare (lizing)

☐ Qira

☐ Blerje me këste

☐ Një kombinim i këtyre

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit

